

04/01/2017

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE
"MARINI TRANS " SH.P.K.**

Sipas Ligjit Nr 9901 dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëria Tregtare" dhe Ligjit nr 9723 i 03.05.007 për "Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" themelohet sot në datën 04.Janar.2017, shoqeria " Marini Trans " shpk. Adresa e shoqërisë është Lagjia "Dyli Haxhire" Rruga "Kadri Hoxha", NSHU Ndërtesa në Zona kadastrale Nr.8526 me Nr.Pasurie 2/303, Elbasan, me ortak të vetëm, Z.Shpendi Saliu, i biri i Fehtiut lindur në datën 26.01.1970, në Elbasan, dhe banues në Lagjia "28 Nentori" PII 421/5 Elbasan, të pajisur me kartën e identitetit numër 030516128, qytetar shqipëtar.

VENDOSI:

Krijimin e një shoqërie tregtare me emrin " Marini Trans " sh.p.k. me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Themeluesi, si një ortak i vetëm, krijon shoqërinë tregtare " Marini Trans " shpk, me statusin ligjor të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në bazë të ligjit nr 9901 të 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me burimet e veta financiare dhe kontributet e paguara në cash.

Neni 2

Kompania gjëzon statusin e personit juridik dhe aktivitetet e saj rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi, sipas këtij akt themelimi dhe Statutin e aneksuar.

Neni 3

Kompania do të ushtrojë biznesin e saj nën emrin " Marini Trans ", shpk, dhe ky emertim do të shënohet në të gjitha dokumentet, letrat, faturat, etj.

Kompania ka vulën e vet në të cilën është shkruar " Marini Trans " shpk, Elbasan, Shqipëri.

Neni 4

Selia e kompanisë është e vendosur në Lagjia "Dyli Haxhire" Rruga "Kadri Hoxha",NSHU Ndërtesa në Zona kadastrale Nr.8526 me Nr.Pasurie 2/303, Elbasan.

Kompania ka kopetenza të hapë dhe të mbyllë agjencitë e tjera në qytete të tjera të Shqipërisë apo jashtë vendit, nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 5

Përiudha e aktivitetit të kompanisë do të jetë e pakufizuar, përveç në rastet kur anëtari vendos një shpërbërjen e menjëhershme të aktivitetit.



Neni 6

Kompania ushtron veprimtarinë e saj me objekt:

Transport kombëtar dhe ndërkontebëtar mallrash për vete dhe për të tretë. Shoqëria mund të kryejë aktet e nevojshme që bordi i administrimit i quan të nevojshme për përbushjen e objektit të shoqërisë ku përfshihen: - Kryerja e operacioneve tregtare dhe industriale, lënia peng e pasurive të paturdhshme, duke përfshirë blerje, shitje, dhe shkëmbim i mallrave, ose të drejtave pronësore të regjistruara dhe të pasurive të paturdhshme; - Kërkon cfardo formë e financimit nga huadhënësit, bankat, shoqëritë dhe individët, duke dhënë garancitë e duhura. Jep garanci dhe grande, garanton kolaterale për llogari të palëve të treta: Merr pjesmarje dhe interesa në shoqëri, bashkime shoqërish dhe bizneset në përputhje me dispozitat e Ligjit: - Merr pjesë në bashkime shoqërish apo grupe. – Ble shoqëri dhe bën investime në kompani të tjera.

Neni 7

Me vendim të themeluesit, kompania mund të ndryshojë emrin, vendin, statusin ligjor dhe qëllimin e punës, mbasi të deklarojë ndryshimet në këtë akt dhe në statutin e saj.

Neni 8

Kapitali i kompanisë i paguar plotësisht në mjete monetare është caktuar fillimisht nga ortaku i vetëm në masen 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali shoqërisë përbëhet nga 1 pjesë me një vlerë nominale 100.000 lekë , dhe është i ndarë keshtu:

Z. Shpendi Saliu zotëron 100 për qind të kapitalit të shoqërisë.

Neni 9

Kompania zhvillon biznesin e saj për të bërë fitime. Ajo është përgjegjëse për detyrimet që ka ndaj shtetit dhe ndaj personave të tjerë, që nga themelimi i saj.

Neni 10

Kompania kryen aktivitetin e saj administrativ, ekonomik e finansiar, në përputhje me legjisacionin aktual dhe me statutin e bashkangjitur.

Drejtimi i shoqërisë do të bëhet nga organet e saj drejtuese, të cilat përbëhen prej ortakut të vetëm dhe administratori i saj..

Ortaku i vetëm merr vendim për emërimin e ekspertit kontabël.

Kompania do të mbajë llogaritë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe do të krijojë një fond rezervë.

Fitimi neto që do të rezultojë në fund të çdo viti finansiar, pas zbritjes së fondit rezervë dhe humbjeve të rezultuara nga vitet e mëparshme, do ti shperndahet ortakut të vetëm.



Neni 11

Përcaktimi i strukturës organizative të kompanisë, funksionet, dhe dorëheqja e organeve të tij merren nga organet drejtuese.

Administrator i shoqërisë " Marini Trans " shpk, emërohet zoti Shpendi Saliu me një afat 5-vjecar. Marrëdhëniet e Punës, do të bazohen në kontratat e punës, dhe ne ligjin përkatës.

Neni 12

Rregullat për menaxhimin, organizimin dhe prishjen e shoqërisë, janë përcaktuar në statut që është bashkëngjitur në këtë akt themelimi.

Ortaku vetëm i shoqerise

" Marini Trans " shpk

Shpendi Saliu

